



KONTRATË SHITJE E KUOTAVE TË KAPITALIT

Në shoqërinë me Përgjegjësi të kufizuar

“NDRICIMI-AL” SHPK

Në Fier, sot me datë 28 janar 2019(nentembedhjete) , përpara meje noteres Flora XH.,ZOTO anëtare e Dhomës së Noterisë Fier, me seli në Lgja “29 Nentori “ Rruga “Dervish Hekali”Fier u paraqitën personalisht,

Palët e mëposhtme :

SHITESI : Saimir Hoxha , atesia Luto , I datelindjes 19/03/1979 , lindur ne Ngjeqar Fier e banues ne Fier, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per te vepruar identifikua prej meje noteres me leternjoftim Nr Personal: H90319091H date leshimi 05/04/2010 , ortaku i vetem ne shoqerine « **NDRICIMI –AL 2018** » Sh.pk,me seli ne Fier lagja Apollonia rruga Lami Lonka , ZK 8534 , rregjistruar si person juridik dhe pajisur me Certificate rregjistrimi ne organin tatimor **NIPT L83028402V** , zotërues i 1 kuote në kapitalin shoqëror të shoqërisë “NDRICIMI-AL ” Shpk, e cila përfaqëson 100% të Kapitalit Shoqëror.

BLERËSI: Ervin Meta , atesia Nail , shtetas shqiptar , i datëlindjes 22/06/1976 , lindur dhe banues në Fier , madhor, me zotësi juridike dhe për te vepruar, identifikuar prej meje noteres me leternjoftim numer 027634992 dhe numer personal H60622083O date leshimi 24/09/2009 mbajtës i kartës së identitetit P01043713

Të cilët me vullnet të lirë e të plotë, më kërkuan redaktimin e kësaj kontrate shitje kuotash në respektim të dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “ i ndryshuar, si më poshtë:

Shitësi Saimir Hoxha , është ortak i vetëm zotërues i 1 kuote në Shoqërinë “NDRICIMI-AL “ shpk, e cila është një shoqëri tregtare shqiptare e regjistruar si person juridik në Regjistrin Tregtar të Shoqërive Tregtare, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me datë 28/06/2018, me Nipt L83028402V

Nepermjet vendimit te dates 28. Janar 2019 Ortaku i vetëm i shoqerise “NDRICIMI-AL “shpk, ka miratuar largimin e tij nga shoqeria dhe shitjen e 1 kuote të zotëruar prej tij në shoqëri të cilat përfaqësojnë 100 % të kapitalit shoqëror në favor të ortakut të ri Ervin Meta .

Ortaku i vetëm i shoqërisë “Ndricimi –AL “ shpk largohet nga shoqëria me vullnetin e tij të lirë dhe ka rënë dakort që kuota e cila përfaqësonë 100% te kapitalit te shoqërisë të përbërë nga kapitali i nënshkruar, të transferohen tek ortakut i ri Ervin Meta kundrejt çmimit 100,000 lekë (njqind), i cili ka shprehur vullnetin e tij për të blerë këte kuote duke trashëguar të gjithë kapitalin e nënshkruar të shoqërisë, asetet dhe të drejtat reale.

Objekti i kontrates

Shitësi Saimir Hoxha , i cili është ortak i vetëm zotërues i 1 kuote në shoqërinë “NDRICIMI –AL ” Shpk transferon nëpërmjet shitjes tërësisht këte kuote , me vullnet të lirë e të plotë, në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, ligjit 9901 datë 14.04.2008 “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “, i ndryshuar, Statutin e Shoqërisë dhe vendimit të Ortakut të Vetëm të shoqërisë datë 28 Janar 2019 , në favor të blerësit ortakut te ri Ervin Meta .

Çmimi i shitjes

Çmimi i shitjes së kuotes të zotëruar nga ortakut i vetëm i shoqërisë “NDRICIMI –AL ” Shpk, i cili përfaqësonë kapitalin e shoqërisë të përbërë nga kapitali i nënshkruar, dhe që transferohen nëpërmjet kësaj kontrate në favor të ortakut të ri Ervin Meta , është 100 ,000 (njëqind) lekë.Palet deklarojne se çmimi i shitjes do te paguhet nepermjet bankes me lidhjen e kesaj kontrate .

Garancitë

Shitësi deklaron dhe garanton blerësin se është i vetmi titullar i ligjshëm i kuotave që po transferohen nëpërmjet kësaj kontrate dhe se ato janë të lira nga çdo barrë apo pretendim tjetër ligjor

Heqja dorë nga të drejtat

Shitësi deklaron nën përgjegjësinë e tij personale, se nuk ka më asnjë pretendim nga shoqëria “NDRICIMI-AL ” Sh.p.k.dhe heq dorë nga të gjitha të drejtat që i takojnë mbi zotërimin e kuotes , kapitalit shoqëror, që po transferon nëpërmjet kësaj kontrate. Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe pagimin e plote te cmimit , pagese e cila do te behet nepermjet bankes ,shitësi gjithashtu zhvishet nga të gjitha detyrimet nga sot e në të ardhmen.

Të ndryshme

Pas realizimit të këtij transferimi (dhe pagimit te cmimit) me nënshkrimin e kësaj kontrate, shitësi zhvishet tërësisht nga zotërimi i kuotave të cilat po transferohen, ndërsa **blerësi Ervin Meta** , bëhet zotërues i ligjshëm i 1 kuote e cila përfaqësonë 100 % te kapitalit të shoqërisë i përbërë nga kapitali i nënshkruar, asete të shoqërisë dhe merr përsipër çdo të drejtë dhe detyrim që i takon nga zotërimi i kësaj kuote në shoqërinë “Ndricimi –AL “ shpk.

Pjesët përbërëse të kontratës

Pjesët përbërëse të kësaj kontrate janë: *ekstrakti i shoqërisë “Ndricimi-Al ” shpk, fotokopjet e dokumentave identifikuese të palëve në këtë kontratë, vendimi i Ortakut të Vetëm të shoqërisë.*

Kjo kontratë u hartua nga unë noterja në katër ekzemplarë me vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, dhe pasi shpreh vullnetin e lirë e të plotë të palëve në këtë kontratë, nënshkruhet regullisht sipas ligjit nga shitësi dhe blerësi përpara meje dhe unë noterja vërtetoj rregullshmërinë e tyre.

SHITËSI

BLERËSI

ERVIN META

Saimir Hoxha

4 NOTERE
FLORA XH. ZOTO

Flora Xh. Zoto